



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
MINISTRI

Nr. 7236 . Prot.

Tiranë, 25.09.2015

U D H Ë Z I M

Nr. 36 , datë 25.09 .2015

PËR
PËRZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 26 dhe nenit 29 të ligjit nr. 69/2102, datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

U D H Ë Z O J:

1. Kandidati për anëtar i Këshillit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar i nënshtrohet konkurrimit publik në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.
2. Kandidati për anëtar i Këshillit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar duhet të përmbushë këto kritere:
 - a. Të jetë shtetas shqiptar.
 - b. Të jetë i padënuar penalisht, me vendim të formës së prerë të gjykatës.
 - c. Të mos jetë në kushtet e konfliktit të interesit.
 - d. Të mos ketë qenë i ndëshkuar më parë me masa disiplinore të natyrës së pezullimit të përkohshëm të ushtrimit të profesionit.
 - e. Të ketë jo më pak se 10 vjet përvojë drejtuese dhe menaxhuese në arsimin parauniversitar, si dhe të ketë përvojë pedagogjike në mësimdhënie.
 - f. Të zotërojë mirë gjuhën angleze ose një gjuhë tjetër të BE-së (me dëshmi).
 - g. Të ketë dhënë kontribut prej më shumë se 10 vjetësh në zhvillimin e arsimit parauniversitar nëpërmjet botimeve, studimeve, vëzhgimeve, analizave e raporteve të kryera.
 - h. Të ketë marrë pjesë në simpoziume, kongrese, konferenca ose në kërkime shkencore brenda ose jashtë vendit në fushën e arsimit parauniversitar.

3. Aplikimi i kandidatit për anëtar të Këshillit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar të kryhet sipas afateve të shpallura në faqen zyrtare ëeb të MAS-it.
4. Kandidati për anëtar i Këshillit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar konkurren me anë të dosjes personale.
5. Dosja e kandidatit për anëtar të Këshillit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar të përmbajë:
 - a. Kërkesën.
 - b. Jetëshkrimin.
 - c. Diplomën e studimeve universitare dhe/ose pasuniversitare (kopje të noterizuar);
 - d. Listën e botimeve, vëzhgimeve, studimeve, raporteve dhe kopje të tyre në fushën e arsimit parauniversitar.
 - e. Tri referenca nga institucione shtetërore ose organizata me të cilat ka bashkëpunuar për çështje të arsimit parauniversitar.
 - f. Dëshmi penaliteti.
 - g. Të dhëna mbi punësimin (fotokopje e librezës së punës).
 - h. Çmime, medalje apo tituj/grada të dokumentuara, të marra në fushën e arsimit parauniversitar.
6. Dosja e kandidatit për anëtar të Këshillit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar paraqitet në protokollin e MAS-it ose përmes shërbimit postar sipas afatit të shpallur nga MAS.
7. Kandidati për anëtar i Këshillit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar përzgjidhet nga Komisioni i përzgjedhjes të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar, i ngritur në MAS.
8. Komisioni harton raportin e vlerësimit të kandidatëve.
9. Komisioni, mbi bazën e vlerësimit të kryer, i propozon ministrit të Arsimit dhe Sportit kandidatët e përzgjedhur për anëtarë të Këshillit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar.
10. Komisioni për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar të respektojë kriterin e barazisë gjinore.
11. Ngarkohen për zbatimin e këtij Udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm dhe Komisioni i përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar.

Ky Udhëzim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren Zyrtare".

MINISTËR

LINDITA NIKOLLA

